

MIRË SE VINI NË ARSIMIN PARASHKOLLOR!

ARSIMI PARASHKOLLOR DO TË FILLOJË
TË ENJTEN, MË 10 GUSHT 2023 DHE DO TË
MBYLLET TË PREMTEN, MË 31 MAJ 2024



Vantaa
Vanda

Mirë se vini në arsimin parashkollor!



Arsimi parashkollor do të fillojë të enjten, më 10 gusht 2023 dhe do të mbyllet të premten, më 31 maj 2024.

Arsimi parashkollor është pjesë e një rrugëtimi që zgjat gjithë jetën, të nxënit, që fillon në shtëpi, vazhdon me arsimin e hershëm dhe atë parashkollor dhe, më tej, me arsimin bazë. Qëllimi i arsimit parashkollor është që, në bashkëpunim me familjen, të nxisë zhvillimin dhe të mësuarit e fëmijës si dhe të forcojë aftësitë e tij praktike shoqërore dhe besimin e shëndoshë në vetvete. Arsimi parashkollor është i detyrueshëm dhe i bazuar në objektiva sipas një programi mësimor. Për çdo fëmijë, do të përpilohet një plan i posaçëm mësimor bazuar në nevojat e tij, në bashkëpunim me prindërit a kujdestarët.

Në arsimin parashkollor fëmijët përjetojnë dhe mësojnë gjëra të reja në grup me moshatarët. Mësimi përbëhet nga module të veçanta me shtrirje dhe metoda të ndryshme zbatimi që bazohen në interesat e fëmijës dhe në objektiva të përgjithshme mësimore. Në këtë nivel, mësimi zhvillohet kryesisht përmes lojës, për të cilën lihet gjithmonë kohë gjatë orarit ditor. Përveç lojës, aktivitetet dhe metodat e ndryshme eksperimentuese ofrojnë përvoja të gjalla dhe nxisin me tej dëshirën e fëmijëve për të mësuar.

Regjistrimi

Regjistrojeni fëmijën në arsimin parashkollor në periudhën 5–31 janar 2023.

Regjistrimi bëhet në mënyrë elektronike, përmes shërbimit VaSa, ose duke e lënë dorazi kërkesën për regjistrim në qendrën e kujdesit ditor. Qendrat e arsimit parashkollor janë radhitur në faqen në internet të Vantaa-s vantaa.fi/esiopetus.

Rezultatet e pranimit në arsimin parashkollor do të mund të shihen përmes shërbimit VaSa, me afat të fundit javën e 14-të.

Arsimi parashkollor është pa pagesë dhe përfshin një vakt

Arsimi parashkollor zhvillohet gjatë ditëve të shkollës, për katër orë në ditë. Ky arsim është pa pagesë, përfshirë edhe një vakt i përditshëm ushqimi. Përveç arsimit parashkollor, fëmijët kanë mundësi të marrin pjesë edhe në mësimin e hershëm plotësues i cili është me pagesë. Nevoja për mësimin e hershëm plotësues, duhet komunikuar gjatë regjistrimit në arsimin parashkollor.

Njohja me gjuhët dhe mundësitë e zgjedhjes së tyre në arsimin parashkollor

Çdo grup fëmijësh në arsimin parashkollor do të njihet gjatë vitit me gjuhët dhe kulturat e ndryshme të grupit. Planifikimi dhe zhvillimi i mësimin do të mbështetet edhe në shkallën e njohjes së gjuhës amtare dhe kulturës së origjinës nga ana e familjeve përkatëse.

Informacione të mëtejshme mbi zgjedhjet e gjuhëve në arsimin parashkollor gjenden në vantaa.fi/kaksikielinenesiopetus.

Bashkëpunimi me shkollën

Gjatë një viti mësimor, fëmija do të njihet me kulturën e punës dhe mjedisin e mësimin në shkollë. Në Vantaa, çdo qendër parashkollore ka një shkollë partnere me të cilën bashkëpunon për aktivitete të ndryshme. Këto përfshijnë, për shembull, veprimtari të përbashkëta mes fëmijëve që ndjekin arsimin parashkollor dhe atyre të arsimit të hershëm fillor, sikurse dhe vizita në shkollë. Në periudhën e pranverës së vitit parashkollor, të dhënat e fëmijëve u dërgohen shkollave të tyre të ardhshme, në bashkëpunim me prindërit a kujdestarët. Qëllimi është që fëmijës t'i sigurohet një

kalim i kollajtë nga niveli parashkollor në atë shkollor si dhe një vazhdimësi mbështetjeje për mësimin me fillimin e shkollës.

Procesi mësimor përgatitor për arsimin parashkollor u jep mundësi fëmijëve të mësojnë në finlandisht

Procesi mësimor përgatitor për arsimin parashkollor organizohet për fëmijë me të kaluar emigrimi, aftësitë praktike të të cilëve në gjuhën finlandeze janë të pamjaftueshme për të mësuar si duhet në grupin e arsimit parashkollor.

Mësimi përgatitor zhvillohet gjatë ditëve të shkollës, për pesë orë në ditë. Katër orë zhvillohen në kuadrin e arsimit parashkollor ndërsa një orë organizohet në grup më të vogël.

Prindërit/kujdestarët i regjistrojnë fëmijët e vet në arsimin parashkollor e, pas kësaj, bien dakord me qendrën përkatëse parashkollore dhe me koordinatorin për gjuhën e kulturën për mundësinë e pjesëmarrjes së fëmijës në orët e procesit përgatitor.

Për më tepër, ju ftojmë të vizitoni qendrat që ofrojnë arsimin parashkollor!

Gjithë qendrat e arsimit parashkollor do të organizojnë një takim njohës për familjet në maj. Qendrat do të njoftojnë prindërit dhe kujdestarët për këto takime.

Çfarë të pëlqen më shumë në arsimin parashkollor?

“Lojërat, kur dalim jashtë dhe edukatoret që janë të dashura. Edukatore Minna është e mirë. Edukatore Petra bën shumë shaka. Luan gjithmonë me ne. Edhe shokët më pëlqejnë.”

Miro, 6 vjeç